

2. Komiteti 07/07/2023

KUVENDI
NR 2153 DATE 06.07.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 803 prot.

Tiranë, më 05.07.2023

Lënda: Mbi riklasifikimin e pagave sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023, si dhe disa ndryshime në strukturën organike

Znj. LINDITA NIKOLLI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Për dijëni:

Z. ULSI MANJA
MINISTËR I DREJTËSISË
Bulevardi "Zogu I-rë", Tiranë

OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT
Rruga e Kavajës, ish-godina e "Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve", Tiranë

E nderuar znj. Nikolla,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim Kolegji) është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b, paragrafi 5, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe si një gjykatë me juridiksion disiplinor.

Kolegji në përmbushje të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" mbështetet nga personeli këshillimor dhe punonjësit administrativë. Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 92/2017, i ndryshuar me vendim nr. 35/2022, ka miratuar strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Apelimit të përbërë nga 57 (pesëdhjetë e shtatë) punonjës.

Sa i takon punonjësve administrativë, pagat e të cilëve referohen në vendimin që trajton pagat e nëpunësve civil në administratën shtetërore dhe institucionet e pavarura, klasat e pagave të përcaktuara në vendim për Kolegjin e Posaçëm të Apelit, janë si më poshtë:

Sekretar i Përgjithshëm -	I-a
Drejtor -	II-b
Përkthyes -	II-b
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë -	III-a
Specialist -	III-b
Sekretar i Kryetarit -	Sekretar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", që ka shfuqizuar VKM nr. 187, datë 08.03.2017, në kreun II - Kategoritë, klasat dhe elementet përbërës të pagës bruto mujore, ka bërë një organizim të ri të klasave, pagës për pozicion dhe elementëve përbërës të pagës bruto mujore.

Në kreun IV të vendimit, ngarkohen institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, të propozojnë ndryshimet në strukturat dhe organikat ekzistuese për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave të përcaktuara në këtë vendim, duke bërë lidhjen midis klasave ekzistuese dhe atyre të reja.

Riklasifikimi i pagave për punonjësit administrativ të Kolegjit të Posaçëm të Apelit paraqitet si më poshtë:

Nr.	Funksioni organik	Paga aktuale		Paga e propozuar	
		Klasa e pagës	Paga për pozicion (lekë në muaj)	Klasa e pagës	Paga për pozicion (lekë në muaj)
1	Sekretari Përgjithshëm	I-a	150.500	I-1	235.000
2	Drejtor	II-b	107.000	II-1	155.000
3	Përkthyes	II-b	107.000	II-1	155.000
4	Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	86.500	III-1	115.000
5	Specialist	III-b	65.200	IV-1	80.000
6	Sekretar i Kryetarit		73.500		90.000

Referuar sa më sipër, në kushtet kur ndryshimi (sipas vendimit nr. 325, datë 31.05.2023) i klasave të pagave për punonjësit administrativ të Kolegjit, sjell nevojën për ndryshim të vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, të ndryshuar, Kolegji vlerëson, se përveç përshtatjes sipas klasave të reja të pagave, në strukturën organike janë të nevojshme dhe ndryshimet si vijon:

1. Riklasifikim i pagës për funksionin organik “Drejtor” nga klasa II-1, në klasën I-4

Referuar nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelit funksionon si dhomë e dytë e Gjykatës Kushtetuese. Përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 325, datë 31.05.2023, klasa e pagës për funksionin organik “Drejtor” në Gjykatën Kushtetuese ishte II-a.

Në këto kushte, ashtu sikundër kemi kërkuar edhe më parë, është shumë e rëndësishme që punonjësit administrativ në të dyja dhomat e Gjykatës Kushtetuese të kenë trajtim të barabartë. Personeli administrativ në të dy dhomat kryen detyra të njëjta dhe po aq të rëndësishme për mbështetjen e veprimtarisë së Gjyqtarëve por dhe për gjykimet e çështjeve. Deri më tani, nëpërmjet ndryshimeve që ka pësuar vendimi i Kuvendit nr. 92/2017, është barazuar klasa e pagës për funksionin organik “Specialist”, ndërkohë që është e domosdoshme të ketë trajtim të barabartë edhe sa i takon funksionit organik “Drejtor”.

Propozimi për trajtimin me të njëjtën klasë I-4, për të dy drejtorët e drejtorive në Kolegji, i është referuar edhe trajtimit të barabartë sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023, ku Drejtorët e Drejtorive me funksione të Nëpunësit Zbatues, sipas legjislacionit për menaxhimin buxhetor e financiar (në rastin e Kolegjit, Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse), janë trajtuar me klasë page të njëjtë me Drejtorët e Drejtorive të cilët janë përgjegjës për çështjet e zhvillimit dhe politikave të sektorit që mbulon institucioni si dhe për çështjet rregullatore (në rastin e Kolegjit, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun).

Së fundmi vlerësojmë se propozimi për riklasifikim të kategorisë së pagës për funksionin organik “Drejtor”, rregullon edhe hierarkine e pagave brenda Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve, ku pozicioni “Përkthyes” është trajtuar që në fillim të veprimtarisë së institucionit, me klasë page të njëjtë me “Drejtorin”.

Përpos argumentave të mësipërme, riklasifikimi i kategorisë motivohet edhe me rritjen e ngarkesës së punës në Kolegji, kryesisht këto dy vitet e fundit.

Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve, sipas parashikimeve në rregulloret e brendshme të Kolegjit, është drejtoria, veprimtaria e së cilës i shërben në mënyrë të drejtëpërdrejtë zhvillimit të procesit gjyqësor (në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit dhe atij disiplinor) përmes sektorëve si: sekretaria gjyqësore, përkthimi, redaktimi, media dhe denoncimet nga publiku.

Gjatë menaxhimit të çdo procesi gjyqësor, prej fillimit e deri në përmbyllje të tij, duke asistuar në të gjitha hapat administrativ dhe procedural të ndërmarrë nga trupat gjykyuese, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve është përballur me një rritje të ngarkesës së punës, të secilit prej sektorëve të mësipërm. Gjatë dy viteve të fundit, kjo drejtori është vendosur përballë detyrimit për të menaxhuar gati dyfishimin e stafit, që ka ardhur si nevojë për përballimin e ritmit të shtuar në gjykim.

Nga 38 vendime që janë shpallur gjatë vitit 2021, ky numër është rritur në 49 vendime gjatë vitit 2022, ndërkohë që vetëm brenda qershorit 2023 janë shpallur 25 vendime. Sipas këtyre përlllogaritjeve, Kolegji ka tejkalar jo vetëm numrin prej 16 vendimesh të periudhës janar - qershor 2021, por edhe numrin prej 23 vendimesh për periudhën janar - qershor të vitit 2022.

Duhet mbajtur parasysh gjithashtu që shifrat e vendimeve të Kolegjit do të kulmojnë gjatë muajit korrik 2023, pasi brenda muajit korrik janë planifikuar të shpallen mbi 12 vendime.

Gjithashtu, Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve, është duke trajtuar kërkesa të tjera, gjithnjë e në rritje, në funksion të procesit, të tilla si: kërkesa për rishikim vendimi, kërkesa për përjashtim dhe dorëheqje etj. Vetëm gjatë vitit të fundit, numri i kërkesave të tjera, të rregjistruara në Kolegj është 107 krahasuar me 18, një vit më parë (viti 2022).

Drejtorja Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse gjithashtu, i është përgjigjur ngarkesës së shtuar dhe përshpejtimit të rritmit të gjykimit, me efikasitet, në fushat/sectorët kryesorë të lidhur në mënyrë të ndërsjelltë me procesin e gjykimit. Kjo drejtori, ka mbështetur veprimtarinë gjyqësore të Kolegjit, në të gjitha hallkat e saj, duke nisur nga protokollit, proceset e transmetimit, pasqyrimin në faqe, regjistrimit audio-video si dhe mundësimin e të gjitha kushteve teknike për mirëfunksionimin e seancave gjyqësore, gjithnjë e në rritje, gjatë vitit të fundit.

Lidhur me këtë propozim, në varësi të vendimarrjes që do të ketë nga Gjykata Kushtetuese sa i takon klasifikimit të pagës për pozicionin “Drejtor”, Kolegji i Posaçëm i Apelit ruan të drejtën të përcjellë në Kuvend, kërkesën për çdo ndryshim klasifikimi në pagë që mund të rezultojë për këtë pozicion.

Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 775.000 (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

2. Riklasifikim i pagës për funksionin organik “Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë” nga klasa III-1, në klasën II-1

Në propozimet e përcjella Kuvendit të Shqipërisë, që në momentin e krijimit të Kolegjit është kërkuar si pjesë e strukturës organike të institucionit edhe “Drejtorja e Marrëdhënieve me Publikun dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar”, në analogji me Gjykatën Kushtetuese.

Në strukturën e miratuar me vendimin e Kuvendit nr.92/2017, të ndryshuar, nuk është miratuar një drejtori e tillë, por pozicioni “Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë” është përfshirë në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, si dhe është diferencuar në pagë nga niveli i specialistit të drejtorisë.

Ky pozicion aktualisht mbulon disa fusha si:

- Mbajtje e marrëdhënieve me median për çdo seancë gjyqësore të zhvilluar në Kolegj, në të dyja juridiksionet; ndjekja e seancave gjyqësore, përgatitja e njoftimeve për shtyp, dërgimi mediave dhe komunikime të vazhdueshme deri në publikimin e tyre në media. Kujdes i veçantë për pasqyrimin në kohë reale në media të njoftimeve të vendimit dhe monitorim i pandërprerë i lajmeve në kanalet mediatike.
- Mbajtje e marrëdhënieve me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Jashtme, Zyrën e Kryenegociatorit pranë Kryeministrit në mënyrë shumë më intensive pas hapjes së procesit të negociatave, duke marrë pjesë në takime, përgatitje raportimesh dhe qëndrimesh të institucionit, person kontakti për projekte të iniciuara, trajnime.
- Si koordinator për të Drejtën e Informimit, koordinim, përgatitje draft- përgjigjesh, vlerësim i situatave në kuadër të menaxhimit të shumicës së kërkesave për informacion

dhe gjithë detyrimeve që i linden institucionit në kuadër të ligjit për të Drejtën e Informimit dhe zbatimit të udhëzimeve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit lidhur me Programin e Transparencës, përfshirë këtu edhe përditësimin periodik të këtij të fundit.

Në propozimin e bërë për ndryshimin e kategorisë për këtë pozicion pune jemi referuar edhe faktit që klasifikimi i pagës për “Koordinatorin” që në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017, të ndryshuar, është trajtuar si pozicion i veçantë, në përputhje kjo edhe me vetë specifikën e veprimtarisë së institucionit.

Nga konsultimi me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, vihet re, se kategoria e pagës e përcaktuar për pozicione të veçanta pune në institucione si Kryeministri (Koordinator) është klasa II-1, apo Agjencinë për Media dhe Informim (Koordinator në Agjencinë për Media dhe Informim) është klasa II-1 etj.

Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 595.000 (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë.

3. Ndryshimi nga pozicioni “Sekretar i Kryetarit”, në pozicionin “Këshilltar pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit”

Kolegji i Posaçëm i Apelit funksionon si dhomë e dytë e Gjykatës Kushtetuese, e cila në strukturën e saj përmban edhe “Njësinë e Kabinetit të Kryetarit”. Që në fillimet e veprimtarisë së Kolegjit, kemi kërkuar shtimin në strukturën organike të “Kabinetit të Kryetarit” në analogji me Gjykatën Kushtetuese.

Aktualisht Kryetari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit ka në strukturë vetëm pozicionin “Sekretar i Kryetarit”, i cili trajtohet me pagë 90.000 lekë si “Sekretar në Kabinetin e Kryetarit të Kuvendit”. Ky punonjës që prej fillimit të veprimtarisë së institucionit asiston Kryetarin e Kolegjit, duke përmbushur detyra funksionale të cilat shkojnë përtej detyrave të thjeshta administrative të këtij pozicioni, që lidhen me përgatitjen e materialeve/ raporteve të ndryshme së bashku me këshilltarë të Njësisë së Shërbimit Ligjor; harton projektvendimet që do të shqyrtohen në Mbledhjen e Gjyqtarëve etj.

Këshilltari pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit ka për detyrë mbështetjen e Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve, sipas parashikimeve në nenin 8 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese” si dhe realizimin e kompetencave të përcaktuara në nenin 13 të ligjit 84/2016 dhe legjislacionin e zbatueshëm brenda kufijve të kompetencave të Kryetarit.

Në nenin 5, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, përcaktohet se: nëpunësit civilë të administratës së Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të shërbimit civil për aq sa nuk bien ndesh me këtë ligj dhe trajtohen financiarisht njëjloj si administrata e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kuptim, kategoria e pagës që ka në Kuvend pozicioni “Këshilltarët e grupeve parlamentare” është klasa I-3, pozicion ky i ngjashëm me pozicionin e propozuar në Kolegji “Këshilltar pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit”.

Gjithashtu nga konsultimi me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, vihet re që për funksione të ngjashme pune si “Këshilltar i Komisioneve të përhershme në KLGJ” është përcaktuar niveli i pagës, klasa II-1.

Sa më sipër, propozimi ynë është që pozicioni “Këshilltar pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit” të ketë klasën II-1.

Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 1.090.000 (një milion e nëntëdhjetë mijë) lekë.

4. Shtesë në strukturën organike për 6 (gjashtë) punonjës për funksione ekzistuese, që aktualisht mbulohen nga punonjës me kontratë të përkohshme pune.

Vendimi nr. 56, datë 01.02.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”, ka përcaktuar 7 (shtatë) punonjësve me kontratë të përkohshme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit si më poshtë:

- 1 (një) pozicion Sanitar 6 orë/ditë, vjetore;
- 1 (një) pozicion Punëtor mirëmbajtjeje 6 orë/ditë, vjetore;
- 1 (një) pozicion Specialist protokoll/arkivë 6 orë/ditë, vjetore;
- 1 (një) pozicion Specialist 6 orë/ditë, vjetore;
- 3 (tre) pozicione Sekretar gjyqësor 6 orë/ditë, vjetore;

Duke pasur parasysh që shumica e këtyre pozicioneve me kontratë të përkohshme pune kanë funksionuar prej vitesh, duke u miratuar vit pas viti me VKM-të përkatëse dhe për rrjedhojë nuk bëhet fjalë për shtesë të mirëfilltë në strukturën organike, vlerësojmë të nevojshëm përfshirjen në strukturën organike për 6 (gjashtë) punonjës për funksione ekzistuese, që aktualisht mbulohen nga punonjës me kontratë të përkohshme pune si më poshtë:

• Specialist sekretarie gjyqësore (3)

Kolegji i Apelit gjykon në trupa gjyqësore me 5 gjyqtarë të zgjedhur me short, për ankimet e paraqitura ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, për kërkesat për rishikim/interpretim vendimi (JR) si dhe në trupa gjyqësore me 3 ose 7 gjyqtarë për ankimet ose kërkesat e paraqitura nga subjektet që legjitimohen në kuadër të juridiksionit disiplinor.

Numri i çështjeve për t'u shqyrtuar nga Kolegji ka vijuar të rritet ndjeshëm gjatë dy viteve të fundit 2022 dhe 2023, kjo edhe për shkak se mandati i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është drejt përfundimit, që e cila sjellë ngarkesë pune të shtuar me të cilën do të përballet sekretaria gjyqësore.

Caktimi i një specialisti sekretarie gjyqësore për çdo çështje të regjistruar në juridiksionin e rivlerësimit apo në juridiksionin disiplinor bëhet duke u nisur nga parimi i barazisë në ngarkesën në punë. Aktualisht, 5 sekretare gjyqësore me kohë të plotë dhe 3 me kontratë të përkohshme pune, asistojnë 7 gjyqtarët e Kolegjit, si dhe Njësinë e Shërbimit Ligjor, që me vendimin nr. 35/2022 të Kuvendit, ka shkuar në 25 këshilltarë, nga 10 këshilltarë që kanë qenë në krijimin e këtij Kolegji, sipas vendimit nr. 92/2017, të Kuvendit.

Përveç çështjeve të regjistruara për ankimet e paraqitura ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, me vendimin e marrë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen “Besnik Cani kundër Shqipërisë”, janë shtuar kërkesat e regjistruara nga ish-subjektet e rivlerësimit për rishikim/interpretim vendimi. Prej vitit 2021 deri në prill të vitit 2023 janë regjistruar 28 kërkesa nga ish-subjektet e rivlerësimit, nga të cilat 22 kërkesa janë regjistruar vetëm gjatë vitit 2023.

Gjithashtu, me vijimin e funksionimit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit është rritur numri i çështjeve të regjistruara në kuadër të juridiksionit disiplinor. Që nga fillimi i veprimtarisë së tij, pranë Kolegjit janë regjistruar në total 18 çështje që i përkasin juridiksionit disiplinor.

Specialisti i sekretarisë gjyqësore përveç detyrave procedurale në përputhje me legjislacionin gjyqësor në fuqi, kryen edhe shumë detyra të tjera të natyrës administrative, të lidhura me çështjet në të cilat marrin pjesë (ndër të tjera, edhe skanimi i çdo akti/ prove/ vendimi/ relacioni që përfshihet në dosje).

Me shtimin e numrit të specialistëve të sekretarisë gjyqësore, do të bëhet e mundur që çdo gjyqtar si dhe Njësia e Shërbimit Ligjor të ketë një asistencë më të lartë teknike në përgatitjen e dosjes gjyqësore nga ana administrative e gjykimit.

Për sa më sipër, vlerësojmë të nevojshme përfshirjen në strukturën organike të Kolegjit të 3 (tre) punonjësve në pozicionin “Specialist sekretarie gjyqësore” me kontratë të përkohshme pune, duke mos kërkuar punonjës me kontratë për vitin 2024 për këtë pozicion pune.

Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 1.715.000 (një milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

- **Specialist protokoll/arkivi (1)**

Aktualisht proceset e punës të protokoll/arkivit së institucionit, kryhen nga 1 (një) specialiste me kohë të plotë sa i takon protokollit dhe nga 2 (dy) specialiste me kontratë të përkohshme pune, me kohë pune 6/ orë në ditë, miratuar me VKM-në nr. 56, datë 01.02.2023, njëri nga të cilat është ngarkuar kryesisht me procesin e përpunimit tekniko-shkencor (detyrim që rrjedh nga ligji nr. 9154 datë 06.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”), ndërkohë që specialisti tjetër asiston të dy

proceset e punës në varësi të ngarkesës. Procesi i përpunimit tekniko - shkencor të fondit arkivor ka përfunduar për vitet 2017 dhe 2018. Duke pasur parasysh volumin e madh të dokumentacionit shkencor, administrativ dhe gjyqësor të prodhuar dhe administruar nga institucioni për periudhën 2019-2023, si dhe faktin që, për shkak të përfundimit të mandatit të Kolegjit, procesi dorëzimit të gjithë fondit arkivor (2017-2026), nuk mund të shtyhet më shumë se muaji dhjetor 2026.

Për sa më sipër vlerësojmë të nevojshme përfshirjen në strukturën organike të Kolegjit të një punonjësi të dytë në pozicionin "Specialist protokoll/arkivit" si dhe mos rinovimin e kontratës për 1 (një) specialist në këtë pozicion, me kontratë të përkohshme pune.

Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.

- **Punonjës mbështetës (2)**

Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka të punësuar me kontratë të përkohshme pune 1 (një) punonjës pastrimi dhe 1 (një) punonjës mirëmbajtje. Këto dy pozicione me kontratë të përkohshme pune kanë funksionuar si të tilla që prej vitit 2018, duke u miratuar vit pas viti me VKM-të përkatëse.

Numri i konsiderueshëm i zyrave dhe ambienteve ndihmëse, në selinë kryesore ku ushtron aktivitetin Kolegji, që kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme me karakter ditor, si nga ana higjienike ashtu dhe teknike, hidraulike etj, duke bërë të domosdoshme këto pozicione.

Duke filluar nga muaji shtator 2022, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ushtron aktivitetin e tij, përveç se në godinën kryesore edhe në ambiente të marra me qira, të cilat gjithashtu kanë nevojë për mirëmbajtje.

Për sa më sipër vlerësojmë të nevojshme përfshirjen në strukturën organike të Kolegjit të dy punonjësve, 1 (një) punonjës pastrimi dhe 1 (një) punonjës mirëmbajtje, duke bërë të mundur funksionimin normal të veprimtarisë edhe në këtë drejtim.

Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 490.000 (katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë.


Për gjithë sa më sipër, vlerësojmë se ndryshimet e kërkuara në strukturë do të kenë një impakt pozitiv në motivimin dhe qëndrueshmërinë e personelit administrativ të Kolegjit, si dhe një ndikim të drejtpërdrejtë në përballimin e ngarkesës së shtuar, me qëllim përmbylljen e të gjithë proceseve gjyqësore dhe administrative, brenda mandatit kushtetues dhe ligjor të Kolegjit.

Bashkëlidhur lutem gjeni Lidhjen nr.1, ku janë reflektuar ndryshimet sipas propozimeve.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KRYETARI

Albana Shtylla
Albana Shtylla



**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE
TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT**

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
		(2)
I. KRYETAR	G3*	1
Këshilltar pranë Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Kryetarit	II-1	1
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		(6)
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		(25)
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	14
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	11
IV. SEKETAR I PËRGJITHSHËM	I-1	1
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(17)
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	8
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	2
Përkthyes	II -1	4
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II -1	1
Specialist pritje me popullin	IV-1	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(12)
Drejtor	I- 4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	1
Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT**	IV-1	2
Specialist protokoll/arkivë***	IV-1	2
Magaznier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/Korrier	V	1
Punonjës mirëmbajtje	III	1
Total		63

Shënim:

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.